

BizTECH *Student*

GAZETA STUDENTORE E TIRANA BUSINESS UNIVERSITY

“E ARDHMJA FILLON KËTU”

Tirana Business University

Një vizion që u bë realitet

MOODLE - PLATFORMA QË NA NDIHMON ÇDO DITË NË TBU



A KENI DËGJUAR PËR MASTERAT E RINJ QË NISIN KËTË VIT NË TBU?

TBU PODCAST



Studenti i TBU, ALBIAN ULLORJA, pjesë e Kombëtares U20 të Shqipërisë në basketboll



TBU: Më shumë se një diplomë, një trampolinë drejt së ardhmes



TBU NË PANAIRET E KARRIERËS - ATY KU NISIN ZGJEDHJET E SË ARDHMES



Sot, TBU është më shumë se një institucion arsimor: është një qendër zhvillimi për të rinjtë shqiptarë, një komunitet i gjallë ku zhvillohen klube studentore, nisma sipërmarrëse, debate, podcast-e, trajnime dhe aktivitete që synojnë të përgatisin një brez të ri liderësh.

Të dashur studentë,

Me shumë kënaqësi ju përshëndes në këtë numër të parë të TBU BizTech Student, një hapësirë e re komunikimi dhe frymëzimi, krijuar për studentët e TBU dhe nga studentët e TBU.

Kjo gazetë nuk është thjesht një botim. Është një dritare ku do të reflektohet **zëri juaj, idetë tuaja dhe ambiciet tuaja**. Është vendi ku bashkohen mendimet kritike, kreativiteti, ambicia për të bërë ndryshim dhe dëshira dhe guximi për të ndërtuar një të ardhme të përbashkët më të mirë.

Tirana Business University College ka si mision të edukojë liderët e së nesërme – profesionistë që mendojnë ndryshe, që sjellin risi dhe që kanë kurajën të veprojnë. Kjo gazetë është një shembull i gjallë i këtij misioni, sepse ju jeni krijuesit e saj.

Ju inkurajoj të kontribuoni me ide, analiza, opinione dhe histori inspiruese nga vendi dhe bota. Mos kini frikë të pyesni, të sfidoni, të propozoni dhe të ndani mendimet tuaja. Shoqëria ka nevojë për mendje të guximshme.

Urime redaksisë dhe gjithë studentëve që do të jenë pjesë e këtij projekti të bukur dhe novator. Jam krenare për secilin prej jush dhe mezi pres të lexoj çdo faqe të kësaj gazete që nis sot rrugëtimin e saj.

Me respekt dhe besim,

Prof. Dr. Vasilika Kume

Rektore, Tirana Business University College.



Të dashur studentë dhe anëtarë të komunitetit TBU,

Një shprehje nga Will Rogers, aktor amerikan, që është mjaft popullore në Britaninë e Madhe thotë se “nuk ke kurrë një mundësi të dytë që të lesh një përshtypje të parë”. Me këtë thënie dhe me shumë kënaqësi dhe besim në potencialin tuaj, ju prezantoj me numrin e parë të gazetës studentore – TBU BizTech Student! Kjo gazetë studentore është konceptuar si një hapësirë për zërin tuaj, vendi ku idetë, pasionet, opinionet dhe frymëzimi të mund të marrin formë. Është një platformë që iu përket juve, studentëve të Tirana Business University College.

Motoja e gazetës është menduar që të jetë: “*The Future Starts Here*” – pikërisht për shkak të besimit se e ardhmja që dëshirojmë nuk është thjesht një horizont i largët, por që mund të nisë pikërisht këtu, në auditore, në diskutimet mes nesh, në iniciativat e përbashkëta që ndërmarrim, në idetë që shpalosim, në artikujt që shkruajmë dhe në frymëzimin që nxisim tek të tjerët.

TBU BizTech Student synon të jetë më shumë sesa një gazetë studentore. Ajo synon të bashkojë dhe të krijojë ura lidhëse mes studentëve me ide dhe pasion për dijen, biznesin, teknologjinë, kreativitetin dhe jetën. Këtu do të gjeni lajme nga jeta studentore në universitet, nga aktivitetet e përditshme të tij, opinionet studentore, intervista nga ana e studentëve me profesorët e tyre dhe profesionistët nga fusha të caktuara, projekte inovatore, suksese të studentëve të TBU, dhe shumë më tepër.

Për të garantuar suksesin e kësaj gazete, na duheni ju, studentë të TBU. Çdo student dhe studente është i/e ftuar të kontribuojë – si autor, fotograf, dizajner, intervistues apo thjesht si dikush që ka ide për të ndarë. Nuk ka rëndësi nëse është artikulli yt i parë apo i dhjeti; rëndësi ka dëshira për të kontribuar për të qenë pjesë e kësaj nisme të re.

Kjo është ftesa jonë për ty: bëhu pjesë e kësaj aventure! Na dërgo mendimet e tua, sugjerimet, temat që të interesojnë. Bëhu pjesë e redaksisë sonë. Sepse kjo gazetë është aq e fortë dhe e bukur sa është edhe zëri i studentëve të TBU! Në këtë rrugëtim të ri, le të ndërtojmë së bashku një hapësirë që na frymëzon të mendojmë më thellë, të ëndërrojmë më guximshëm dhe të veprojmë më me pasion.

Sepse e ardhmja... fillon këtu.

Prof. Asoc. Dr. Gerti Sqapi

TBU – Një vizion që u bë realitet

Kur arsimi nuk duhet të jetë vetëm dije, por edhe përgatitje për jetën reale, lindi nevoja për një universitet ndryshe. Kjo ishte filozofia mbi të cilën u themelua Tirana Business University (TBU) – një institucion që prej ditës së parë synoi të krijojë një standard të ri në arsimin e lartë në Shqipëri.

TBU u themelua me bindjen se tregu i punës kërkon më shumë se thjesht diploma: kërkon mendim kritik, aftësi ndërveprimi, sipërmarrje, etikë profesionale dhe njohuri praktike. Që në fillimet e tij, universiteti e vendosi veten si një urë lidhëse mes botës akademike dhe realitetit të tregut – një filozofi që vazhdon të udhëheqë çdo program, leksion apo iniciativë të tij.

TBU është themeluar mbi tri shtylla kryesore:

1. Cilësia akademike, me staf pedagogjik të përzgjedhur dhe me eksperiencë kombëtare dhe ndërkombëtare;
2. Orientimi drejt praktikës, përmes programeve të integruara me projekte reale, internship-e dhe bashkëpunime me kompani të mirënjohura;
3. Zhvillimi i personalitetit të studentit, duke ofruar një ambient ku nxitet mendimi i lirë, ndërmarrësia, debati dhe krijimtaria.

Programet e ofruara nga TBU përfshijnë fusha si Marketing, Menaxhim, Kontabilitet-Financë, Inxhinieri Kompjuterike, Inxhinieri Software, Informatikë Ekonomike, duke u përditësuar vazhdimisht me nevojat e kohës dhe transformimet digjitale.

Ndërkombëtarizim dhe partneritete

Që prej themelimit, TBU ka ndjekur një strategji të qartë për ndërkombëtarizimin. Marrëveshjet me universitete evropiane, mundësitë për shkëmbime studentore dhe pjesëmarrja në projekte të përbashkëta ndërkombëtare kanë krijuar një mjedis akademik me horizont të hapur dhe frymë globale.

Me auditorë modernë, ambiente dinamike, staf të përkushtuar dhe qasje pedagogjike bashkëkohore, TBU vazhdon misionin e tij të pandalshëm: të formojë profesionistë të denjë për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.

TBU – Një universitet i ndërtuar mbi vlera, me sytë nga e ardhmja.



Më shumë se një **DIPLOMË**, një **TRAMPOLINË** drejt së ardhmes - Nga Klevisa Aliaj

Shumë prej nesh kur mendojnë për universitetin e shohin atë si një stacion të domosdoshëm që duhet kaluar për të marrë një diplomë. Si një etapë formale, hapi tjetër i rradhës pas gjimnazit që duhet "të mbyllet me sukses", për të nisur më pas karrierën, jetën e vërtetë. Por realiteti është krejt ndryshe, sidomos në një kohë kur tregu i punës kërkon shumë më tepër se thjesht njohuri të mbledhura nga librat dhe shënimet në fletore. Sot, më tepër se kurrë, universiteti është vendi ku ndërtojmë themelet e jetës sonë profesionale dhe personale. Dhe për ata që zgjedhin Tirana Business University (TBU), kjo përvojë merr një dimension krejt të veçantë.

Në TBU, nuk ndihesh si një dëgjues pasiv, studenti që mezi pret të mbarojë leksionet për t'iu kthyer rutinës. Përkundrazi, ndihesh pjesë e një komuniteti që të sfidon dhe të nxit të përfshihesh aktivisht në një shumëllojshmëri aktivitete por jo vetëm. Që nga projektet e para praktike e deri tek diskutimet e hapura në klasë, gjithçka është menduar e ndërtuar për të nxitur mendimin kritik, bashkëpunimin dhe zgjidhjen e problemeve reale. Është një mënyrë mësimi që të "detyron" të dalësh nga 'comfort zone', të sfidohesh, të gabosh, të biesh e të ngrihesh sërish.

Pikërisht këtë e bën të veçantë eksperiencën në TBU: që asgjë nuk mbetet vetëm te teoria e te leksionet me shumë slide. Mësimi nuk ndalet në auditore, por vazhdon në aktivitete të shumta, vizita në kompani, diskutime me drejtues dhe profesionistë të fushës. Shpesh janë këto momente që hapin dritare të reja, ku kupton më qartë se si funksionon industria dhe çfarë kërkohet për të siguruar vendin tënd mes një konkurrence "të frikshme".

Për një student ditët e sotme, nuk mjafton vetëm të mësojë për provimet e sezonit apo të zgjidhë ushtrimet. Botës ku do të dalim nesër i duhen njerëz që dinë të komunikojnë, të punojnë në grup, të marrin përgjegjësi, të jenë kuriozë dhe të përshtaten shpejt. TBU është pikërisht hapësira ku nisim t'i kultivojmë këto aftësi; qoftë përmes projekteve që bëjmë, debateve që kemi në klasë, apo sfidave që na dalin kur përballemi me situata reale nga bota e biznesit dhe teknologjisë.

Dhe kjo falë mënyrës si strukturohen programet e studimit; na ndihmojmë të rritemi personalisht përtej anës akademike e profesionale. Këtu mëson të menaxhosh kohën, të përballosh stresin, të komunikosh me të tjerët dhe të kesh vetëbesim: cilësi këto, që janë po aq të rëndësishme sa çdo dije profesionale. Dhe kjo ndodh natyrshëm, duke marrë pjesë në aktivitete të shumta, gara, klube apo iniciativave të ndryshme sociale.

Në fund të ditës, kur mendon përse vlen universiteti, kupton që nuk është fjala vetëm për të marrë një diplomë me një logo prestigjioze. Është për të kaluar disa vite ku përgatitesh realisht për jetën. Dhe në TBU kjo ndodh çdo ditë-jo si një proces i ngurtë, por si një rrugëtim i gjallë, ku teoritë që mëson në mëngjes i sheh të zbatohen në praktikë pasdite, ku takon njerëz të suksesshëm që kanë qenë pikërisht aty ku je ti sot, dhe ku çdo hap i vogël që bën të çon më afër objektivave të tua.

Në një universitet si TBU, çdo ditë e kaluar është një investim konkret në të ardhmen. Jo vetëm për shkak të njohurive që fiton, por edhe për shkak të përvojave që të ndryshojnë si person, të rrisin ambicien dhe të japin guximin për të synuar më lart. E ndoshta ky është thelbi i vërtetë i arsimit të lartë: të mos dalësh prej tij vetëm me një diplomë, por me bindjen dhe aftësinë që mund të ndërtohesh vetë si profesionist dhe si individ i plotësuar në çdo aspekt. Kështu që, kur dikush të pyesë "pse ke zgjedhur TBU?", përgjigjja në këtë rast nuk është "për të marrë një diplomë", por "për të ndërtuar të ardhmen time që tani, hap pas hapi". Sepse sot, më shumë se kurrë, e ardhmja fillon tani. Dhe në TBU, e ndjen këtë që në momentin e parë që hyn në auditore.

– Platforma që na ndihmon çdo ditë në TBU

Një hapësirë online ku studentët dhe pedagogët ndajnë materiale, detyra dhe njoftime të rëndësishme.

Sot, teknologjia është bërë e pandashme në jetën e një studenti. Në TBU, një nga gjërat që e tregon këtë ndryshim është përdorimi i platformës Moodle. Studentët në TBU e frekuentojnë platformën Moodle shumë herë, ndoshta edhe më shpesh se rrjetet sociale, sidomos gjatë sezonit të provimeve.

Moodle është një Sistem për Menaxhimin e Mësimit (LMS) i krijuar për t'u ofruar pedagogëve, administratorëve dhe studentëve një sistem të vetëm, të fuqishëm, të sigurt dhe të integruar, për të ndërtuar mjedise të personalizuar mësimore. Pasi fillon semestri, aty gjejmë gjithçka që na duhet: syllabus-in, temat e lëndëve, prezantimet e leksioneve, detyrat që duhet të dorëzojmë dhe njoftimet e profesorëve. Është kthyer në një vend ku çdo student kthehet herë pas here gjatë vitit akademik.

Secili student ka llogarinë e tij personale me emër dhe fjalëkalim dhe pasi hyn, mund të shohë të gjitha lëndët që ndjek. Për secilën lëndë, mund të gjejmë prezantimet e leksioneve, detyrat, datat e dorëzimit dhe çdo material tjetër që ka vendosur profesori. Moodle mund të aksesohet në çdo pajisje elektronike, si telefon, tablet apo laptop, në aplikacion ose në WEB.

Në Moodle, të gjitha materialet ndodhen të organizuara sipas lëndës dhe javës. Kur një student humbet një leksion, atë do e gjejë të ngarkuar në platformë. Dorëzimi i detyrave është shumë i lehtë, thjesht ngarkohet skedari online, pa pasur nevojë për përdorimin e USB-së, CD-së apo printimeve të kushtueshme. Në fund të semestrit, vlerësimet hidhen në menunë "grades", duke shmangur nevojën për të shkuar në sekretari për të pyetur për notën.

Megjithatë, ndodh që Moodle nuk përdoret në mënyrë të barabartë nga të gjithë. Ajo kryen punën e saj si LMS vetëm nëse pedagogët ngarkojnë materialet rregullisht dhe përdorin funksionet e ndryshme të platformës, si njoftimet, detyrat, testet dhe forumet. Në këtë mënyrë studentët përfitojnë maksimalisht. Por ndodh që në disa lëndë, pedagogët nuk ngarkojnë materiale ose e përdorin shumë pak platformën, sepse preferojnë mësimin tradicional me shpjegime në klasë dhe shënime në fletore dhe nuk përgatisin PowerPoint shpjeguese, ose ka pedagogë që i përgatisin por nuk i ngarkojnë ato në platformë. Kjo e penalizon shumë një student që mund të humbasë një apo disa orë leksion, sepse nuk ka akses në materialet që mungojnë online.

Një sfidë tjetër është që Moodle nuk njofton gjithmonë kur ngarkohet diçka e re. Nëse nuk e hapim vetë, mund të humbasim ndonjë afat detyre pa e kuptuar. Pedagogët e kujdesshëm kujdesen të dërgojnë njoftime edhe në email për çdo ngarkesë që bëjnë, por jo të gjithë e bëjnë këtë.

Pavarësisht këtyre sfidave, Moodle është një ndihmë shumë e madhe për studentët e TBU-së. Na ndihmon të jemi më të organizuar, na jep akses të lehtë në gjithçka që ka lidhje me shkollën, dhe na lehtëson komunikimin me pedagogët. Kjo platformë na mundëson të studiojmë në mënyrë më të pavarur dhe të përgatitemi më mirë për provimet, duke pasur gjithmonë në dispozicion materialet e nevojshme. Me kalimin e kohës dhe me përdorimin më të gjerë nga pedagogët dhe studentët, kjo platformë pritet të bëhet edhe më e mirë dhe të lehtësojë më shumë procesin e të mësuarit.

–Nga Lea Licanji

5 KËSHILLA QË ÇDO STUDENT DUHET T'I DIJË PËR TË PASUR SUKSES NË UNIVERSITET

-Nga Bora Bubjaku

Jeta studentore është një nga periudhat më të bukura, por edhe më sfiduese në jetën e një të riu. Mes seminareve, provimeve, miqësive të reja dhe ëndrrave për të ardhmen, shpesh ndodh që studentët të ndihen të mbingarkuar ose të humbasin fokusin. Ja pesë këshilla praktike që do t'ju ndihmojnë të menaxhoni më mirë kohën, energjinë dhe ambiciet tuaja.

1. Menaxho kohën si profesionist

Koha është një nga pasuritë më të mëdha të studentit. Një orar i mirëorganizuar ju shpëton nga stresi para provimeve dhe ju lë hapësirë për aktivitete të tjera. Përdor aplikacione si Google Calendar, Notion ose një agjendë klasike për të ndarë detyrat ditore, studimin dhe kohën për veten.

2. Mos e neglizho shëndetin mendor

Stresi i provimeve, presioni për rezultate dhe jeta sociale mund të ndikojnë në shëndetin mendor. Bëj pushime kur ndihesh i lodhur, flit me dikë kur ke nevojë dhe mos e nënvlerëso fuqinë e një gjumi të mirë. Universiteti është një garë afatgjatë – jo një sprint!

3. Ndërto rrjetin tënd që në fillim

Mos e mendo rrjetëzimin si diçka që vlen vetëm pas diplomimit. Merr pjesë në aktivitete studentore, klube, trajnime dhe evente. Njerëzit që takon sot, mund të jenë kolegët, bashkëpunëtorët apo punëdhënësit e nesërm.

4. Bëj pyetje, kërko ndihmë

Mos u ndje në siklet nëse nuk kupton diçka. Pyet profesorët, bashkëstudentët apo kërko ndihmë në bibliotekë. Universiteti është vendi ku të mësosh si të mësosh është po aq e rëndësishme sa të marrësh nota të larta.

5. Gjej balancën mes studimeve dhe jetës personale

Po, nota të mira janë të rëndësishme, por nuk janë gjithçka. Gjej kohë për hobet, miqtë, sportin, artin – çfarëdo që të bën të ndihesh mirë. Një student i lumtur dhe i ekuilibruar ka më shumë gjasa të ketë edhe sukses akademik.

Përfundim:

Universiteti nuk është vetëm një vend për të marrë një diplomë – është për të ndërtuar veten si njeri. Këto këshilla janë thjesht një udhërrëfyes fillestar. Çdo rrugëtim është i veçantë, por me përkushtim, organizim dhe pak kujdes për veten, çdo student mund ta shndërrojë këtë periudhë në bazën më të fortë të së ardhmes së tij.



NË PANAIRET E KARRIERËS

Tirana Business University (TBU) ka qenë një ndër aktorët më aktivë në panairët e universiteteve të zhvilluara gjatë këtij viti akademik në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Me një prezencë të fortë dhe një qasje dinamike, TBU u ka ofruar maturantëve informacion të plotë, përvojë të drejtpërdrejtë dhe mundësi për të parë nga afër çfarë do të thotë të jesh pjesë e një universiteti modern, që ndërthur dijen me praktikën.



Një turne informues në gjithë Shqipërinë. Gjatë muajve të fundit, stafi i TBU-së ka marrë pjesë në panairë të arsimit të organizuara në Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Elbasan, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë dhe Kukës, duke takuar mijëra maturantë nga e gjithë Shqipëria. Çdo ndalesë ka qenë një mundësi për të komunikuar drejtpërdrejt me të rinjtë që janë përballë një prej zgjedhjeve më të rëndësishme të jetës së tyre: zgjedhjes së universitetit.



Stenda e TBU ka spikatur për interaktivitetin, energjinë dhe përfaqësimin serioz, ku studentë aktualë, pedagogë dhe përfaqësues të Zyrës së Marketingut kanë ndarë informacione mbi programet e studimit, bursat, jetën studentore, mundësitë e punësimit dhe projektet ndërkombëtare.



“Më shumë se një broshurë – një eksperiencë e drejtpërdrejtë”

Në vend të promovimit klasik, TBU ka sjellë në këto panaire formate të hapura komunikimi, mini-workshope, intervista live, sfida kreative dhe dhurata simbolike që kanë afruar maturantët me frymën e universitetit. Ata janë njohur nga afër me programe si Menaxhim, Marketing, Kontabilitet-Financë, Inxhinieri Software, Inxhinieri Kompjuterike, Informatikë Ekonomike si dhe me avantazhet që ofron TBU për karrierën pas diplomimit.

“Kemi zgjedhur të jemi pranë maturantëve në mënyrë të drejtpërdrejtë, me pyetje reale dhe përgjigje të sinqerta. Ne nuk ofrojmë thjesht një diplomë – por një eksperiencë universitare me vlerë të vërtetë,” – thekson ekipi organizator i TBU.



TBU, zgjedhja e atyre që mendojnë për nesër

Panairot kanë qenë gjithashtu një mënyrë për të shpërndarë mesazhin kryesor të TBU: të studiosh me synim për të krijuar ndikim, jo vetëm për të marrë një diplomë. Me qasje bashkëkohore në mësimdhënie, staf të kualifikuar dhe partneritete ndërkombëtare, TBU është pozicionuar si një nga universitetet më praktike dhe të orientuara drejt tregut të punës në vend.

Panairot përfunduan, por udhëtimi sapo ka nisur. Tirana Business University ju mirëpret në një të ardhme që ndërtohet sot – me dije, përvojë dhe vizion.



TBU TIRANA BUSINESS
UNIVERSITY
COLLEGE
PODCAST

Tirana Business University (TBU) ka nisur një nismë të re mediatike që po fiton gjithnjë e më shumë vëmendje: "TBU Podcast" – një platformë audio-vizuale që sjell energjinë, mendimin kritik dhe

kreativitetin e studentëve në qendër të vëmendjes. Podcasti zhvillohet nën moderimin e studentëve Bora Bubjaku dhe Klejvi Pero, në bashkëbisedim të drejtpërdrejtë me pedagogun Brenton Kotorri, i cili sjell perspektivën akademike dhe përvojën profesionale në çdo episod. Ky bashkëkombim mes studentëve dhe stafit pedagogjik e bën podcastin një hapësirë unike dialogu dhe reflektimi.

Në prapaskenë, regjia teknike i është besuar Klejdi Kapos, ndërsa montazhi realizohet nga Ledja Dushku, duke garantuar një prodhim cilësor dhe profesional. E gjithë nisma zhvillohet nën drejtimin e Zyrës së Marketingut të TBU-së, që ka synuar të krijojë një urë moderne komunikimi mes universitetit dhe publikut të gjerë.



Nga ideja te realizimi – një platformë për mendimin kritik "TBU Podcast" trajton tema të ndryshme si sipërmarrja, ndikimi i teknologjisë, marrëdhëniet ndërpersonale, edukimi mediatik dhe sfidat e jetës studentore. Me tone të singerta, shpesh ironike dhe gjithmonë reflektuese, podcasti po kthehet në një dritare ku studentët shprehen lirshëm, ndërsa pedagogët i dëgjojnë dhe i sfidojnë. Më shumë se një podcast – një laborator krijimtarie



Përtej përmbajtjes, kjo nismë po shërben si platformë praktike mësimore për studentët të cilët përfshihen në të gjitha fazat e prodhimit: nga konceptimi i temave, përgatitja e pyetjeve dhe strukturimi i diskutimit, te regjistrimi, montazhi dhe publikimi. Episodet publikohen në YouTube, Spotify dhe në rrjetet sociale të TBU-së, duke arritur një audiencë të gjerë, përtej auditorëve.

TBU Podcast është dëshmi se universiteti nuk është vetëm vend mësimi, por edhe një hapësirë reale ku idetë marrin zë – dhe ai zë tashmë dëgjohet qartë.

TAKIMI I LIGËSSË UNIVERSITETEVE PRIVATE

Pesha e Universiteteve jopublike ka ardhur duke u rritur në programe studimi, në numër studentësh (rreth 34% të pranimeve aktuale), në projekte kombëtare e ndërkombëtare, në cilësinë e akreditimeve institucionale e të programeve të studimit, në metodat e mësimdhënies, infrastrukturë etj. E megjithatë, bashkëpunimi ndëruniversitar mbetet një sfidë e përhershme ashtu si dhe përpjekjet për projekte të përbashkëta kërkimore, shkëmbim përvojash për kurrikulat, bashkëpunim mes studentëve të universiteteve tona e mbi të gjitha në adresimin e shqetësimeve të përbashkëta për një arsim më cilësor dhe më të zhdërvjellët në zgjidhjen e problemeve burokratike.

Në vitin 2017, u themelua Liga e Sipërmarrjes në Arsim, e cila synonte të rriste bashkëpunimin ndëruniversitar në arsimin e lartë jo publikë. Liga e Universiteteve "Gjon Dyrriahium" është e para iniciativë në Shqipëri që synon rritjen e cilësisë dhe lobimin për çështjet që prekin arsimin e lartë.

Në shkurt të 2025-ës, Universitetit European të Tiranës dhe Tirana Business University iu bashkuan shtatë anëtarë të rinj: Universiteti Luarasi, Kolegji Universitar Qiriazi, Universiteti Aldent, Canadian Institute of Technology, Universiteti Polis, Kolegji Profesional i Tiranës dhe Universiteti Metropolitan i Tiranës. Në fillim të muajit prill, Bordi Drejtues pranoi unanimitisht kërkesën e tre universiteteve për t'u bashkuar me Ligën, Universitetit Epoka, Kolegjit Universitar të Biznesit dhe Kolegjit Gjerman, duke e çuar kështu në dymbëdhjetë numrin e anëtarëve. Liga e Sipërmarrjes në arsim është e angazhuar për të çuar para axhendën për rritjen e cilësisë së mësimdhënies e kërkimit shkencor si dhe përpjekjeve të përbashkëta për ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë në Shqipëri. Klima e përshtatshme e krijuar nga ekzekutivi shqiptar krijon mundësi të reja për të ecur më shpejtë për përmbushje të këtij synimi.


Liga e Universiteteve Private Shqiptare zhvilloi së fundmi (25 Qershor 2025) një takim të rëndësishëm strategjik, ku morën pjesë drejtuesit e universiteteve anëtare, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit si dhe aktorë të tjerë të fushës akademike dhe biznesit.

Përfaqësues të 12 universiteteve private, të organizuara në Ligën e Sipërmarrjes në Arsimin e lartë, u mbledh në një ditë të gjatë pune për të çuar para axhendën e politikave të arsimit të lartë. Angazhimi i përbashkët është i gjithanshëm jo vetëm për të rritur bashkëpunimin ndëruniversitar, por edhe për sfidat e pritshme lidhur me rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, ndërkombëtarizimit, rritjen e kapaciteteve njerëzore, ndryshimin e ligjit të arsimit të lartë.

Ky takim u fokusua tek:

Rritja e cilësisë së programeve akademike,
Ndërkombëtarizimi i universiteteve shqiptare,
Forcimi i bashkëpunimit midis institucioneve private,
Krijimi i projekteve të përbashkëta për zhvillimin e studentëve dhe stafit akademik.

Në fjalën e tij, përfaqësuesi i Ligës theksoi se "arsimi i lartë privat ka një rol kyç në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, ndaj bashkëpunimi dhe standardet e përbashkëta janë prioritet absolut".



Liga e Universiteteve "Gjon Durrahium"

-Nga Endi Saliko

TBU është pjesë aktive e Ligës, duke sjellë kontributin e vet në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe në përgatitjen e studentëve për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.

Studentët e TBU marrin pjesë në Konkursin mbi Debatin Universitar

"UNIDEBATE"

Vetëm pak ditë më parë pata privilegjin e madh të përfaqësoja Tirana Business University në "Unidebate", një format i cili zhvillohej për herë të parë në nivel kombëtar në Tiranë, nën organizimin dhe koordinimin e organizatës Liburnetik, Agjensisë Kombëtare të rinisë mundësuar nga Titan Albania & Ministria e Shtetit për të rinjtë dhe fëmijët. Ishte një sfidë e jashtëzakonshme që vendosi përballë dy paneleve pro dhe kundër, disa nga studentët më të mirë të Universiteteve Shqiptare duke i dhënë zë mendimit kritik, vlerave akademike dhe sinergjisë që secili ekip prezantoi dhe shfaqti në këtë format.



Fillimisht ne u përballëm me disa universitete nga e gjithë Shqipëria dhe në fund arritëm të preknim finalen, me përkushtim dinjities, profesionalizëm, dhe koordinim shumë të mirë si elemente thelbësore nga e cila karakterizohej skuadra jonë. Tema e cila u trajtua në finalen e madhe ishte: "Të rinjtë si agjentë ndryshimi, utopi apo realitet?"

Skuadra jonë u pozicionua me short në panelin pro të debatit duke analizuar, hartuar dhe projektuar argumenta llogjikë me një elokuencë të pastër dhe të qartë përballë panelit kundër. Mund të shprehem se ky debat nxorri në pah vlerat edukative që gjithësecili prej nesh mbart, por për më tepër promovimi në formate të tilla nuk qëndron vetëm si një eksperiencë por si një vlerë e shtuar përkrah formimit tonë akademik, personal dhe atij profesional.

Personalisht mendoj që një student asnjëherë nuk duhet të mjaftohet me dijet akademike që ai merr brenda sallës së auditorit, jo se ato nuk janë të rëndësishme por rrjeti që ne krijojmë në formate dhe evente të tilla janë një kombinim shumë i mirë i objektivave së një prespektive të qëndrueshme.

Në përfundim të këtij debati, ne arritëm të fitonim çmimin e dytë me një diferencë shumë të vogël pikësh por rëndësia qëndron tek feedback-u që ne morëm dhe jo rezultati.

Mund të them që ky çmim nuk ishte thjesht një trofe për ne por ishte një dëshmi e qartë dhe një rezultat i një disipine afatgjatë.

Gjej rastin të falenderoj të gjithë stafin akademik të Tirana Business University por në veçanti administratorin e TBU, z. Altin Sholla, i cili fokusin për një qëllim të përbashkët e orienton tek "studenti".

Formate dhe eksperiencia të tilla nuk na bëjnë të përfjethëm vetëm emocione dhe sfida, por na bëjnë të ndihemi krenarë kur ne arrijmë të sjellim një fitore në familjen e madhe TBU, aty ku zhvillohemi dhe rritemi çdo ditë!

Falenderime të singerta!



- Nga Ergi Cjapi

Studenti i TBU-së, **ALBIAN ULLORJA**, pjesë e **Kombëtares U20 të Shqipërisë** në basketboll

Tirana Business University (TBU) është krenare të njoftojë se një prej studentëve të saj, Alban Ullorja, është përzgjedhur si pjesë e Kombëtares shqiptare të basketbollit U20. Ky përfaqësim është një arritje jo vetëm për Albanin, por edhe për komunitetin TBU, që gjithmonë ka mbështetur dhe inkurajuar talentin në të gjitha fushat – nga akademika të sportit.



Alban Ullorja, student në TBU, ka treguar një përkushtim të jashtëzakonshëm si brenda auditorëve, ashtu edhe në fushën e lojës. Pasioni i tij për basketbollin, stërvitja e palodhur dhe performanca e dalluar në kampionatet e mëparshme e kanë çuar deri në grumbullimin me ekipin kombëtar të moshës deri në 20 vjeç, që këtë verë do të përfaqësojë Shqipërinë në arenën ndërkombëtare.

Një rrugëtim drejt suksesit

Kombëtarja U20 do të marrë pjesë në Kampionatin European për këtë kategori moshe, ku përballja me ekipe të forta nga kontinenti kërkon jo vetëm talent, por edhe karakter, disiplinë dhe përfaqësim dinjitoz. Albani është gati të japë kontributin e tij me pasionin dhe energjinë që e karakterizon, ndërsa përfaqëson ngjyrat kuqezi me krenari.

“Është një ndjenjë e veçantë të vesh fanellën e Shqipërisë dhe të jap maksimumin për ekipin tim. Jam mirënjohës për mbështetjen që kam marrë nga familja, trajnerët dhe TBU, ku ndjehem gjithmonë i motivuar për të ecur përpara,” – shprehet Albani.

TBU – një universitet që mbështet pasionin dhe talentin

Tirana Business University është më shumë se një institucion akademik: është një hapësirë ku studentët inkurajohen të zhvillojnë të gjitha dimensionet e tyre – intelektuale, kreative, sociale dhe sportive. Pjesëmarrja e Alban Ullorës në Kombëtare është një dëshmi e angazhimit të TBU për të formuar liderë të ardhshëm në çdo fushë.

A KENI DËGJUAR PËR **MASTERAT E RINJ** që nisin këtë vit në TBU?

Dua t'ju flas për diçka që realisht të entuziazmon. Tirana Business University po sjell tre programe master të reja që janë krijuar fiks për kohët që po jetojmë. Teknologji, marketing digjital, turizëm. Programe që na japin avantazh real në tregun e punës.

Përshembull, masteri në "Data Science and Cybersecurity". Teknologjia që e ndryshon botën. Ky program është për ata që duan të kuptojnë se si funksionon bota e të dhënave dhe si të mbrohen sistemet nga rreziqet kibernetike. Është master shkencor, zhvillohet në anglisht, dhe është ndër më të avancuarit në rajon.

Ky master përfshin edhe AI-Machine Learning edhe Big Data Analytics edhe Ethical Hacking edhe Zhvillimi i softuerëve edhe, edhe, edhe, lëndë të tjera me aplikim praktik. Për këto lëndë do të përdoren gjuhë programimi si Python, R, TensorFlow, simulime reale sulmesh kibernetike, projekte që bëhen në bashkëpunim me kompani #tech lider në treg. Ky master të aftëson për role si Data Analyst, Cybersecurity Expert, Risk Manager, AI Developer, ose kërkues shkencor. Profesione me paga shumë të larta dhe kërkesë globale që po rritet çdo ditë.

TBU | BALFIN

Analizo. Mbro. Transformo.

FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACONIT

Data Science & Cybersecurity NEW

MSH 120 ECTS

+355 69 70 66 966
admissions@tbu.edu.al

TBU | BALFIN

Bëhu profesionist i marketingut të së ardhmes!

FAKULTETI I BIZNESIT & DREJTËSISË

Marketing Dixhital & Komunikim NEW

MP 60 ECTS

+355 69 70 66 966
admissions@tbu.edu.al

Gjithashtu edhe një master i ri në "Marketing Digjital dhe Komunikim". Ky master është ideal për ata që pëlqejnë komunikimin, kreativitetin dhe botën digjitale. Është master profesional, zgjat vetëm një vit dhe zhvillohet në shqip dhe pak anglisht. Programi të mëson si të bësh SEO & SEM që faqet dhe përmbajtja të renditen lart në Google. Si të menaxhosh rrjetet sociale dhe të krijosh fushata që nuk kalojnë pa u vënë re në Instagram, Facebook, LinkedIn, TikTok, çdo platformë. Si të automatizosh marketingun që fushatat të funksionojnë vetë. Si të përdorësh AI për personalizimin e komunikimit dhe të analizosh të dhënat për të kuptuar sjelljen e konsumatorëve dhe për të marrë vendime strategjike. Por më e rëndësishmja, masteri të jep mundësinë të bësh praktikë në çdo kompani të Grupit BALFIN. Pra, nuk merr vetëm teori, por edhe eksperiencë reale, kontakte profesionale dhe mundësi punësimi direkte.

Profesionet që nis pas këtij masteri janë nga më të kërkuarit sot: Menaxher Marketingu Digjital, Content Creator, SEO/SEM Specialist, Brand Manager, Analist të të dhënave, konsulent komunikimi dhe shumë të tjera.

Ndërsa për ata që dashurojnë botën e udhëtimeve, turizmit të mikpritjes dhe eventeve, TBU ka sjellë një tjetër program që ia vlen: masterin profesional në "Menaxhim Turizmi dhe Hoteleri". Ky master është për studentët që duan të punojnë në industrinë e hotelierisë dhe turizmit, të menaxhojnë hotele dhe resorte, të organizojnë evente dhe të zhvillojnë destinacione turistike. Zgjat vetëm një vit dhe zhvillohet në shqip.

Këtu do të mësosh si të menaxhosh në mënyrë strategjike një hotel, si të organizosh evente dhe aktivitete që i japin jetë një destinacioni, si të krijosh përvoja turistike dhe si të përdorësh marketingun digjital për të promovuar destinacionet dhe shërbimet. Studentët punojnë me projekte konkrete si "Green Coast" dhe "Vlora Marina" për të parë nga afër se si funksionon industria në nivelet më të larta. Pas këtij masteri, mund të punosh si Menaxher Hoteli, Koordinator Eventesh, Konsulent për destinacione turistike, Menaxher PR & Marketing në turizëm, ose mund të krijosh biznesin tënd në këtë sektor që po rritet çdo vit.

TBU | BALFIN

Turizmi nuk ndalet,
as ambiciet e tua!

FAKULTETI I BIZNESIT & DREJTËSISË

**Manaxhim Turizmi
& Hotellerie**

MP 60 ECTS

+355 69 70 66 966
admissions@tbu.edu.al

Këto programe janë fiks për kohën që po jetojmë. Nëse doni një karrierë që ju jep jo vetëm dije, por edhe eksperiencë reale dhe lidhje profesionale, këto mastera janë mundësia jonë për t'u bërë profesionistët që tregu kërkon. Unë e kam vendosur që Marketingu është fiks për mua... ndërsa një shoqja ime (ajo e bankës) është super e interesuar për Turizmin.

Po ju? Kush e di, ndoshta kjo është ajo që na duhet për t'i çuar ëndrrat tona një hap më pranë realitetit.

- Nga Ledja Dushku



Numri i parë i gazetës studentore të Tirana Business University, Korrik 2025. ©

Adresa: Rruga Rezervat e Shtetit, Lundër, Tiranë, Shqipëri

Cel: +355 697066966

Tel: +355 42260443

Email: info@tbu.edu.al

